

Termet e Referencës (ToR)

Titulli:

Thirrje për Punësimin e një Studenti Master për Programimin e Robotit NAO me Python për skenarë Mësimorë të nivel parauniversitar

Kohëzgjatja:

1 muaj angazhim

Përshkrimi i Projektit:

Projekti “Ndikimi i robotëve humanoid në mjediset mësimore” është një iniciativë multidisiplinare e koordinuar nga Fakulteti i Edukimit, Universitetit të Prishtinës. Ky projekt ka për qëllim kryesor të hulumtojë ndikimin e teknologjisë së robotëve humanoid dhe sistemeve të ngjashme inteligjente në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies. Përmes këtij projekti, synohet të vlerësohet nëse integrimi i robotëve humanoid në klasat parauniversitare mund të rrisë motivimin, vëmendjen dhe rezultatet akademike të nxënësve me zhvillim tipik dhe atipik. Për më tepër, projekti do të hulumtojë mundësitë që ofron kjo teknologji për studentët e Programit Fillor dhe Programeve Master si Edukimi Inkluziv dhe Mësimdhënia Lëndore, duke përfshirë krijimin e burimeve të hapura mësimore dhe zhvillimin e praktikave mësimore inovative.

Detyrat Kryesore

Studenti i masterit do të ketë këto përgjegjësi kryesore:

1. Programimi i Robotit NAO me Python - Zhvillimi i skenarëve të ndryshëm programimi për robotin NAO, që përputhen me një gamë të lëndëve të nivelit parauniversitar, duke përfshirë lëndët të shkencat natyrore dhe shoqërore.
2. Krijimi i Burimeve të Hapura Mësimore - Krijimi i burimeve të hapura mësimore, që përfshijnë regjistrimin e video-ve të robotit NAO duke kryer aktivitete të ndryshme në klasë, në përputhje me skenarët e programuar.
3. Dokumentacioni i Programimit të skenarëve - Hartimi i dokumentacionit të qartë dhe të detajuar për mësimdhënësit, duke përshkruar se si të përdorin robotin NAO për lëndët e shkollës fillore. Dokumentacioni duhet të jetë i përshtatshëm për mësimdhënësit që kanë pak ose aspak përvojë me programimin.

Kualifikimet e Kërkuara

Kandidatët duhet të jenë studentë aktivë në Universitetin e Prishtinës, që vijnë nga këto programe:

- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike – Programi Inxhinieri Kompjuterike,

- Fakulteti i Shkencave Matematikore dhe Natyrore – Programi Shkenca Kompjuterike,
- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike – Programi Mekatronike.

Të këtë:

- Aftësi të avancuara për programim në gjuhën Python.
- Aftësi të shkëlqyera teknike dhe aftësi për të krijuar skenarë komplekse të programimit për robotikë.
- Aftësi shumë të mira për të shkruar raporte dhe për të krijuar dokumentacion të detajuar teknik në gjuhën shqipe.
- Përvojë e mëparshme me programimin e robotëve humanoid, është avantazh.
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të përmbushur detyrat brenda afateve të caktuara.

Dorëzimet Kryesore

1. Skenarë Programimi për Lëndë të Caktuara - Skenarë të zhvilluar me Python për robotin NAO, që përputhen me lëndët parauniversitare.
2. Burime të Hapura Mësimore (Video) - Regjistrime video të robotit NAO duke ndërvepruar në klasë, sipas skenarëve të programuar.
3. Dokumentacioni i Programimit - Udhëzues i plotë dhe i detajuar për mësuesit, se si të programojnë dhe përdorin robotin NAO për lëndët e shkollës fillore.

Afati i Aplikimit:

Studentët e interesuar duhet të dërgojnë:

- CV të përditësuar që përfshin përvojën e tyre për programim me Python dhe çdo projekt të lidhur me robotikën,
- Një letër motivimi që përshkruan përvojën dhe motivimin për këtë angazhim,
- Çdo punë të mëparshme të lidhur me programimin e robotëve (avantazh).

Afati për dorëzimin e aplikimeve: 15 Tetor 2024

Aplikimi duhet të dërgohet tek Prof. Ass. Krenare Pireva Nuci, në emailin: krenare.nuci@uni-pr.edu.
Subjekti i emailit: Pozita e punës për programimin e NAO Robotit

Detajet e Projektit:

Emri i donatorit: Rektorati,

Koordinatori i projektit: Kenare Nuçi